



Republika e Kosovës  
Ministria e Arsimit, Shkencës,  
Teknologjisë dhe Inovacionit


# STUKTURA KOMBËTARE E ARSIMIT DHE FUSHAT E STUDIMIT NË KOSOVË

Klasifikimet sipas Strukturës  
Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit  
(ISCED 2011) dhe Fushave të Studimit  
(ISCED-F 2013)

---


# Përmbajtja

Fjala hyrëse e Ministres	4
Akronimet	5
I. Hyrje	6
II. Procesi	8
III. Harmonizimi	10
1. Struktura aktuale e arsimit në Kosovë	10
2. Hartëzimi	14
a) Struktura kombëtare - kohëzgjatja dhe mosha	16
b) Struktura kombëtare - kërkesat dhe kualifikimet e marra	17
c) Struktura ISCED dhe përshtatja me arsimin kombëtar	19
3. Profilet e programeve të arsimit të mesëm të lartë	22
4. Kodifikimi ISCED F 2013	22
Hapat e mëtutjeshëm	27
Shtojca 1	28
Pasqyrë për nivelet 0 deri 4 të ISCED	28
Pasqyrë për nivelet 5 deri 8 të ISCED	29
Shtojca 2	30
Shtojca 3 Referencat	44



Ky dokument është hartuar nën udhëheqjen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) me kontributin e grupit punues të përbërë nga përfaqësuesit e MASHTI, Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Agjencisë Kosovare të Akreditimit, Fakultetit të Edukimit/Universiteti “Hasan Prishtina”, Zyrës së UNICEF-it në Kosovë. Analiza dhe raporti është hartuar nga ekspertja ndërkombëtare Aurélie Acoca.

MASHTI falenderon Zyrën e UNICEF-it në Kosovë për përkrahjen teknike dhe financiare përgjatë procesit të shqyrtimit të strukturës kombëtare të arsimit dhe fushave të arsimit sipas klasifikimit ndërkombëtarë ISCED 2011 dhe ISCED-F 2013.





## Fjala hyrëse e Ministres

Harmonizimi i strukturës kombëtare të arsimit të Kosovës me Klasifikimin e Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit (ISCED) 2011, si dhe përafrimi i programeve kombëtare të arsimit të mesëm të lartë me Fushat e Arsimit dhe Trajnimit (ISCED - F 2013) është një hap i rëndësishëm për sistemin arsimor në Kosovë, që mundëson raportimin e të dhënave të arsimit në Kosovë në përputhje me kërkesat dhe standardet e raportimit në nivel ndërkombëtar. Gatishmëria e Kosovës për të raportuar të dhëna në nivelin ndërkombëtar dhe tejkalimi i referencave të vjetruara për ISCED 1997 ishte arsyeja kyçe për fillimin e procesit të harmonizimit me klasifikimet ISCED 2011. Për më shumë, ky proces do të rrisë transparencën në sektorin e arsimit, si dhe do të ofrojë të dhëna të sakta për profilet arsimore, të cilat janë esenciale për procesin e planifikimit dhe për politikat kombëtare që ndërlidhen me kërkesat e tregut të punës.

Rezultatet e këtij procesi do t'i mundësojnë Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) raportimin e statistikave të arsimit dhe llogaritjen e treguesve ndërkombëtarisht të krahasueshëm, si dhe krahasueshmërinë e programeve arsimore të Kosovës me ato të nivelit ndërkombëtar. Konceptet dhe përkufizimet themelore synojnë të jenë të vlefshme në nivelin ndërkombëtar dhe gjithashtu do t'i përmbushin kërkesat e MASHTI-t për raportimin e arritjeve arsimore, duke përfshirë edhe monitorimin dhe raportimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ).

Procesi i hartëzimit të programeve kombëtare në arsimin e mesëm të lartë me Fushat e Arsimit dhe Trajnimit (ISCED - F 2013) synon të përafrojë qasjen në punë dhe të mësuarit e mëtejshëm, duke i bërë kualifikimet të rëndësishme për punësim dhe mësim, si dhe për plotësimin e nevojave të nxënësve, ekonomisë dhe institucioneve arsimore e aftësuese.

Ky raport paraqet një udhërrëfyes për të gjithë zyrtarët e arsimit për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në arsim.

Në emër të Ministrisë, falenderoj grupin punues, konsulentin dhe të gjithë ata që kontribuan në hartimin e këtij dokumenti. Në veçanti falenderoj Zyrën e UNICEF-it në Kosovë për mbështetjen e gjithë procesit.

### **Arbërie Nagavci, ministre**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

## Akronimet

<b>ECTS</b>	Sistemi Evropian i Transferimit të Kredive
<b>ECVET</b>	Sistemi Evropian i kredive për arsimin dhe aftësimin profesional
<b>ISCED</b>	International Standard Classification of Education/ Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit
<b>KKK</b>	Korniza Kurrikulare e Kosovës
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>SMIA</b>	Sistemi Menaxhimit dhe Informativ i Arsimit
<b>SNKA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit / International Standard Classification of Education
<b>UIS</b>	Instituti i Statistikave të UNESCO-s
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë

## I. Hyrje

Qëllimi i këtij dokumenti teknik është ta propozojë hartëzimin e strukturës kombëtare të arsimit të Kosovës në bazë të Klasifikimit Ndërkombëtarë të Standardeve të Arsimit (ISCED) 2011 si dhe përafrimin e programeve kombëtare në arsimin e mesëm të lartë me Fushat e Arsimit dhe Trajnimit (ISCED - F 2013). Udhëzuesi i drejtohet në mënyrë specifike zyrtarëve qeveritarë që punojnë në fushën e arsimit dhe janë përgjegjës për mbledhjen dhe raportimin e statistikave dhe treguesve në sektorin e arsimit.

Rezultatet e këtij procesi do t'ia mundësojnë MASHTI-t raportimin e statistikave të arsimit dhe treguesve të krahasueshëm me shtetet e tjera në mbarë botën, ndërsa programet arsimore do të përkthehen në një grup të kategorive ndërkombëtarisht të krahasueshme. Konceptet dhe përkufizimet themelore të ISCED-it synojnë të jenë të vlefshme në nivelin ndërkombëtar dhe, si të tilla, do të lejojnë që MASHTI ti përmbushë kërkesat për raportimin e arritjeve arsimore në nivelin ndërkombëtarë.

Statistikat ndërkombëtare të arsimit mbledhen nga organizatat: Instituti i Statistikave të UNESCO-s (UIS), Eurostat dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Meqenëse struktura e sistemeve arsimore ndryshon shumë midis shteteve, për të prodhuar statistika dhe tregues të arsimit të krahasueshëm ndërkombëtarisht është e nevojshme të kemi një kornizë për të mbledhur dhe raportuar të dhëna për programet arsimore me nivel të ngjashëm të përmbajtjes arsimore.

Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit ISCED<sup>1</sup>, të zhvilluara nga UNESCO, janë klasifikim referues për organizimin e programeve arsimore dhe kualifikimeve përkatëse sipas niveleve dhe fushave të arsimit. Klasifikimi përdoret për të mbledhur të dhëna kombëtare të cilat më pas përpilohen dhe shpërndahen nga Instituti i UNESCO-s për Statistika (UIS). ISCED 2011 përbën rishikimin e dytë ndërkombëtarë të këtij klasifikimi. Për herë të parë, klasifikimi ISCED u zhvillua në vitin 1976 dhe u rishikua në vitin 1997.

ISCED 2011 mbështetet në tre komponente kyçe:

- i) konceptet dhe përkufizimet e dakorduara ndërkombëtarisht;
- ii) sistemet e klasifikimit; dhe
- iii) hartëzimi i programeve arsimore dhe kualifikimeve ISCED në vende nga e gjithë bota.

1 Shkurtesat ISCED u referohen Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (International Standard Classification of Education) dhe si të tilla mund të gjinden në dokumentet zyrtare të MASHTI-t

Pjesë e ISCED 2011 është edhe ISCED-F 2013 Fushat e Arsimit dhe Trajnimit 2013 që ka për qëllim klasifikimin e fushave të arsimit.

Hartëzimet e ISCED-it janë mjete thelbësore për organizimin e informatave mbi sistemet arsimore kombëtare, programet e tyre dhe kualifikimet përkatëse me qëllim që të sigurohet krahasimi i informatave në nivelin e ISCED-it dhe për të mbështetur interpretimin e tyre për qëllime ndërkombëtare statistikore.

Në Kosovë, deri më tani, është përdorur ISCED 1997 si referencë për klasifikimin e programeve kombëtare. Si do që të jetë, shpjegimi teknik i këtyre klasifikimeve të programeve sipas ISCED 1997 nuk është prezantuar në asnjë dokument zyrtar.

Andaj, ky raport përmbledh procesin për harmonizimin e strukturës aktuale arsimore të Kosovës në klasifikimin ISCED 2011 (pjesa e parë), paraqet hartëzimin me ISCED 2011 dhe ISCED-F 2013 (pjesën e dytë) dhe propozon disa rekomandime për hapat e mëtejshëm.

## II. Procesi

Qëllimi kryesor i ISCED-it është klasifikimi i strukturave kombëtare të arsimit për të siguruar **që të dhënat arsimore janë ndërkombëtarisht** të krahasueshme.

ISCED<sup>2</sup> e klasifikon programin arsimor, që do të thotë **përmbajtjen e kurrikulës** bazuar në program/kualifikim, duke i përdorur kriteret e përafrimit (si për shembull, kohëzgjatja e programeve, kërkesat për qasje (hyrje) në programin arsimor dhe kualifikimi i arritur pas përfundimit të programit) për ta përcaktuar shtrirjen e programeve dhe për t'i klasifikuar ato kur raportojnë të dhëna në nivelin ndërkombëtar. Kriteret e përafrimit janë një grup informacionesh të hollësishme për secilin program arsimor. Në nivelin ndërkombëtar, kriteret e përafrimit janë përkthyer në një sërë pyetjesh për programet arsimore që ndihmojnë në krahasimin e sistemeve arsimore kombëtare në të gjithë botën.

Për Kosovën, kriteret e përafrimit për harmonizimin e programeve arsimore janë:

- a) kohëzgjatja dhe mosha si dhe
- b) kërkesat e qasjes (hyrjes) në program dhe kualifikimet e arritura në fund të programeve.

Për këtë qëllim, në Kosovë u krijua një grup punues që do ta udhëzonte punën e ekspertëve gjatë realizimit të hartëzimit të programeve kombëtare me ISCED 2011 si dhe për përgatitjen e një baze të dhënash që i përmban profilet e programeve të arsimit të mesëm të lartë me kodimin ISCED-F 2013.

Hapi i parë në këtë proces ishte rishikimi i dokumenteve zyrtare relevante për arsimin në Kosovë edhe renditja e të gjitha programeve kombëtare. Dokumentet e shqyrtuara përfshinë kryesisht dokumente të zhvilluara nga MASHTI ose Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Për të kuptuar kornizën ligjore në lidhje me arsimin në Kosovë, janë konsultuar të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative relevante..

Të gjitha dokumentet relevante të shqyrtuara janë radhitur si shtojcë në fund të këtij dokumenti.

2 “Në ISCED, një program arsimor përcaktohet si një grup koherent ose sekuencë e aktiviteteve arsimore ose komunikim i krijuar dhe i organizuar për t'i arritur objektivat e paracaktuara të të nxënimit ose për të përmbushur një grup specifik të detyrave arsimore gjatë një periudhe të qëndrueshme. Objektivat e të nxënimit në mënyrë tipike lidhen me qëllimin e përgatitjes për studime më të avancuara dhe/ose për një profesion, tregti ose klasë profesionale ose zanatesh, por mund të jenë të lidhura me zhvillimin personal ose kohën e lirë. Një karakteristikë e përbashkët e një programi arsimor është që, pas përmbushjes së objektivave të të nxënimit ose detyrave arsimore, bëhet certifikimi pas përfundimit të suksesshëm”; (UIS, 2012, faqe 7)



Gatishmëria e Kosovës për të raportuar të dhënat në nivelin ndërkombëtar, për të lehtësuar procesin e krahasimit të situatës në Kosovë me shtetet e tjera dhe tejkalimi i referencave të vjetruara për ISCED 1997 ishte arsyeja kyçe për iniciimin e procesit të harmonizimit me klasifikimet ISCED 2011. Në përpilimin e dokumenteve strategjike për arsimin në Kosovë, MASHTI ka përdorur klasifikimet ISCED 1997 apo ISCED 2011. Në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021 botuar në vitin 2016, programet kyçe të arsimit u hartëzuan me ISCED 2011 (shih Figurën 1). Si do që të jetë, deri më tani nuk ekziston ndonjë dokument zyrtar që e shpjegon tërësisht procesin e hartëzimit të sistemit arsimor me ISCED 2011 dhe që shpjegon procesin e përafrimit të sistemit arsimor në Kosovë me ISCED 2011.

### Sistemi arsimor në Kosovë është strukturuar si në vijim:




Figura 1 - Shembull i ISCED 2011 i përdorur në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021

Sa i përket klasifikimeve të programeve arsimore dhe fushave të arsimit të mesëm të lartë, ISCED-F 2013 mundëson klasifikimin e programeve kombëtare me 11 fushat ekzistuese. Bazuar në ISCED-F ekzistojnë 11 fusha të përgjithshme (gjëra) të arsimit (00 deri në 10), si dhe një numër i konsiderueshëm i fushave të ngushta dhe të detajuara të arsimit. Ky proces synon t'i kodifikoj programet e arsimit të mesëm të lartë në Kosovë në fushat e hollësishtme të arsimit dhe nga ato t'i përcaktojë fushat e ngushta dhe të detajuara shoqëruese.

## III. Harmonizimi

Variablat kryesore të klasifikimit të ISCED-it janë nivelet dhe fushat e arsimit. Përbrenda niveleve të ISCED-it, programet dhe kualifikimet klasifikohen sipas dimensioneve plotësuese. Kjo përfshin:

- orientimin e programit;
- përfundimin e nivelit ISCED;
- qasjen në nivele më të larta të ISCED-it; dhe
- pozicionin në strukturën kombëtare të gradave dhe kualifikimeve.

Jo të gjitha dimensionet plotësuese vlejnë për të gjitha nivelet. Për më tepër, niveli 0 i ISCED-it më tej është ndarë sipas llojit të programit dhe grupmohës së synuar. Kategoritë dhe nën-kategoritë e ofruara nga këto dimensionet plotësuese lejojnë mbledhje më të detajuara dhe raportimin e të dhënave të krahasueshme ndërkombëtarisht.

Për Kosovën, kriteret e përafrimit për të harmonizuar programe të ndryshme arsimore ishin:

- a) **kohëzgjatja dhe mosha** si dhe
- b) **kërkesat e qasjes (hyrjes) në program dhe kualifikimet e arritura në fund të programeve.**

Por para paraqitjes së hartëzimit të strukturës kombëtare të arsimit me nivelet e ISCED 2011 (Tabela 3), paraqitet sistemi aktual arsimor i Kosovës dhe programet kombëtare të arsimit.

### 1. Struktura aktuale e arsimit në Kosovë

Sistemi arsimor i Kosovës përbëhet nga: arsimi parauniversitar dhe arsimi i lartë (Figura 2). Arsimi parauniversitar rregullohet me Ligjin për Arsimin Parauniversitar (04/L-032) dhe është rigrupuar në katër nivele arsimore:

- **Niveli 0** - Arsimi (mosha zero (0) deri në gjashtë (6) vjeçare; faza kyçe 0 dhe një pjesë e fazës 1 e Kornizës Kurrikulare të Kosovës (KKK), i rregulluar me këtë ligj vetëm për moshën pesë (5) deri gjashtë (6) vjeçare (shkollë parafillore);
- **Niveli 1** - Arsimi fillor i cili zgjat pesë (5) vite ose klasat 1-5 (mosha gjashtë (6) vjeçare, pjesa e mbetur e fazës 1 dhe 2 e KKK);

- **Niveli 2** - Arsimi i mesëm i ulët i cili zgjat katër (4) vite ose klasat 6-9 (mosha dymbëdhjetë (12) vjeçare, faza 3 dhe 4 e KKK);
- **Niveli 3** - Arsimi i mesëm i lartë i cili zgjat tre (3) vite ose klasat 10-12 varësisht nga kurrikulumu i përcaktuar nga MASHTI (mosha pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, faza 5 dhe 6 e KKK), përfshirë gjimnazin, shkollën e mesme profesionale, shkollën e muzikës dhe të artit,
- **Niveli 4** - Institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional për periudhën prej një (1) deri në dy (2) vite, (mosha tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, specializimi pas-sekondar në KKK).
- Programe të mësimit gjatë gjithë jetës për të rriturit që mund të ofrohen në nivelet 3 dhe 4 të ISCED-it.

Arsimi i lartë në Kosovë rregullohet me Ligjin për Arsimin e Lartë (O4/L-037), që grupon këto nivele:

- **Niveli i parë** - tre (3) deri në katër (4) vite studime me të cilat studenti arrin 180, përkatësisht 240 kredi/ ECTS<sup>3</sup> dhe merr diplomën Bachelor.
- **Niveli i dytë** - një (1) deri dy (2) vite studime pas mbarimit të nivelit të parë me të cilat studenti arrin 60, përkatësisht 120 kredi /ECTS dhe studenti merr diplomën Master.
- **Niveli i tretë** - programe të studimeve të doktoratës me karakter akademik dhe hulumtues shkencor të pavarur dhe
- Çdo arsimim tjetër pas shkollës së mesme në nivelet 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të cilin mund të jepen kredi (ECTS).

Pas përfundimit të shkollës së mesme të ulët, nxënësit mund të zgjedhin të vazhdojnë shkollimin në arsimin e mesëm të lartë, gjegjësisht në Gjimnaz apo Arsim dhe Aftësim Profesional. Kurse pas përfundimit të këtij niveli arsimor, nxënësit e kanë të domosdoshme t'i nënshtrohen testit të Maturës Shtetërore nëse dëshirojnë të vazhdojnë studimet në nivelin e arsimit të lartë.

Përveç niveleve të arsimit, kualifikimet lidhen edhe me programet dhe kurrikulën e tyre. **Korniza e vlerësimit të nxënësve në arsimin parauniversitar** në Kosovë i përshkruan veçoritë kryesore të sistemit arsimor, dhe ka ndihmuar edhe në përsosjen e mëtejshme të hartëzimit në mes të niveleve të programeve të arsimit dhe Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës (shih Figurën 3)

3 Shkrutesa ECTS i refereohet Sistemi Evropian i Transferimit të Kredive

Struktura e përgjithshme e sistemit arsimor në Kosovë




Figura 2: Struktura e arsimit në Kosovë

Burimi: Korniza e vlerësimit të nxënësve në arsimin parauniversitar në Kosovë

Figura 3 paraqet nivelet kyçe të arsimit dhe aftësisë, kualifikimin për secilin nivel, mundësitë për avancim, përkatësisht rrjedhat ndërmjet programeve.




Figura 3 - Burimi: Korniza Kombëtare e Kualifikimeve në Kosovë

Burimi i tretë i rëndësishëm për këtë proces dhe që do ta plotësojë KKK është **'Raporti i Referencimit** për Kornizën e Kualifikimeve për **Arsim (KKA) në Kosovë - Korniza Kombëtare e Kualifikimeve'** që paraqet programet e arsimit dhe aftësisë profesionale. Sipas këtij botimi, deri më tani janë zhvilluar 17 fusha profesionale, 140 profile dhe rreth 56 standarde profesionale.

Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional (O4/L-138) identifikon fushat kryesore të vep-  
rmtarisë së arsimit dhe aftësimit profesional si: zhvillimi i kompetencave dhe trajnimi  
për punësimin e individëve në përputhje me profesionet dhe karrierën e tyre sipas  
kërkesave të tregut të punës; krijimi i kulturës së përgjithshme dhe profesionale në për-  
puthje me parimet e arsimit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimet ekonomike, shkencore dhe  
teknologjike; dhe njohja e kompetencave të individëve bazuar në standardet profesio-  
nale të nivelit përkatës.

Bazuar në ligjet në fuqi, programet për Arsim dhe Aftësim Profesional janë pjesë e arsim-  
it të mesëm të lartë dhe dallojnë nga përbërja e tyre dhe mundësitë që pas përfundimit të  
programit të vazhdohet me arsimin e lartë apo në tregun e punës.

Gjithashtu, sipas Ligjit për Arsim dhe Aftësim Profesional (O4/L-138) programet arsimore  
përcaktohen si formale dhe joformale. Arsimi formal i referohet procesit të zhvillimit të  
mësimin në një ambient të caktuar dhe është strukturuar dhe dizajnuar në mënyrë të  
qartë si mësim në aspektin e qëllimeve, kohës apo burimeve. Nga pikëpamja e nxënësit,  
mësimi formal është i qëllimshëm dhe ofron kualifikimet 3 deri 5 nga KKK. Arsimi dhe  
aftësimi joformal i referohet mësimin që shtrihet në aktivitete të planifikuara, por që nuk  
emërtohet shprehimisht si mësim. Nga pikëpamja e nxënësit, mësimi joformal është i  
qëllimshëm dhe ofron kualifikime 2 deri në 5 nga KKK.

Së fundi, **dokumentet zyrtare ligjore dhe udhëzimet administrative** kanë qenë burimi  
kryesorë për të informuar procesin e strukturimit të aspekteve ligjore të strukturës arsi-  
more dhe përcaktimin e kritereve për klasifikimin e programeve në ISCED 2011.

## 2. Hartëzimi

Hartëzimi i ISCED-it është një mjet thelbësor për organizimin e informatave mbi sistemet  
arsimore kombëtare, programet e tyre dhe për ta siguruar krahasueshmërinë e infor-  
matave me nivelet e ISCED-it.

Hartëzimi i ISCED-it për secilin shtet ndihmon për të siguruar që krahasimet ndërkom-  
bëtare të jenë të sakta, më transparente dhe të kuptohen më mirë nga përdoruesit. Pran-  
daj, informatat kontekstuale të paraqitura gjatë hartëzimit janë thelbësore. Informatat,  
ndër të tjera, përfshijnë emrat e programeve kombëtare, moshën teorike të regjistrimit  
apo fillimit të programeve dhe kohëzgjatjen, kërkesat minimale të regjistrimit dhe kual-  
ifikimet e marra pas përfundimit të suksesshëm të programeve. Këto informata janë  
paraqitur së bashku me dimensionet përkatëse të ISCED që do të thotë nivelin e ISCED-  
it, orientimin e programeve dhe nën-kategoritë e përfundimit dhe qasjes, ose për ISCED  
5-8, pozicionin në strukturën kombëtare të niveleve. Gjithsej janë 9 nivele në ISCED 2011  
të paraqitura në Figurën 4.

Figura 4: Nivelet e ISCED-it 2011

**ISCED 2011****0 Edukimi në fëmijërinë e hershme**

- 01 Zhvillimi edukativ në fëmijërinë e hershme  
(i dizajnuar për fëmijët nën moshën 3 vjeçare)
- 02 Parafillor  
(i dizajnuar për fëmijët 3 vjeç e më shumë)


**1 Arsimi Fillor****2 Arsimi i Mesëm i Ulët****3 Arsimi i Mesëm i Lartë****4 Arsimi Pas-sekondar jo terciar****5 Cikli i shkurtër terciar****6 Bachelor ose niveli ekuivalent****7 Master ose niveli ekuivalent****8 Doktoratura ose niveli ekuivalent**

Klasifikimi i programeve kombëtare në nivelet dhe dimensionet plotësuese të ISCED-it mund të përdoret më pas për ta përcaktuar kodin tre shifror ISCED të një programi.

Skema e kodit tre shifror është paraqitur më poshtë:

- Shifra 1 - paraqet nivelet e arsimit
- Shifra 2 - paraqet kategoritë (lloji ose orientimi)
- Shifra 3 - paraqet nën-kategoritë (plotësimi dhe hyrja, ose pozicioni në strukturën e nivelit).

Shifra e tretë është kombinim i përfundimit dhe qasjes për nivelet ISCED 2 deri në 5 dhe pozicionimit brenda strukturës për nivelet ISCED 6 deri në 8 (shiko Shtojcën 1)



Në fund, hartëzimi ofron udhëzime të qarta se si të raportohen të dhënat e arsimit kombëtar për qëllime ndërkombëtare. Për shembull, në Kosovë, ka disa elemente që duhen të merren parasysh për nivelin parashkollor. ISCED ofron një kornizë që u ndihmon statisticienëve të klasifikojnë sisteme të ndryshme arsimore në mënyrë të tillë që të jenë të krahasueshme me të gjitha shtetet.

Figura 5 - Shembull: një program profesional (5) në arsimin e mesëm të ulët (2) me përfundim të plotë dhe qasje në nivelin më të lartë të arsimit (4)

Para paraqitjes së shtrirjes së 19 programeve kombëtare (shih Tabelën 3), elementet e ndryshme të programeve kombëtare diskutohen në kapitujt më poshtë - a) për kohëzgjatjen dhe moshën dhe b) për kushtet për pranim dhe kualifikimet e marra në fund të programeve.

Për të pasur një pasqyrë të përgjithshme të programeve në Kosovë, përveç programeve formale, strukturave arsimore u janë shtuar edhe programet joformale. Ato janë theksuar me shkronja *kursive*.

## a) Struktura kombëtare - kohëzgjatja dhe moshja

Tabela 1: Kohëzgjatja dhe moshja e hyrjes në programe kombëtare

Obligativ	Programet kombëtare	Klasa	Kohëzgjatja	Moshja
Jo	Parashkollor - Çerdhe		3 vite	0 deri 2
Jo	Parashkollor - Kopshte		2 vite	3 deri 4
Jo	Parafillor		1 vit	5
Po	Fillor	1 - 5	5 vite	6 deri 10
	<i>Fillor - arsimi jo formal</i>	<i>Të paktën 2 vjet më shumë se moshja zyrtare e qasjes /hyrjes</i>	<i>2.5 vite</i>	<i>8+</i>
po	I mesëm i ulët	6 - 9	4 vite	11 deri 14
	<i>I mesëm i ulët - Arsimi jo formal</i>	<i>Të paktën 2 vjet më shumë se moshja zyrtare e qasjes/hyrjes dhe dëshmi e përfundimit të arsimit fillor</i>	<i>2 vite</i>	<i>14+</i>
Jo	I mesëm i lartë - Gjimnaz	10 - 12	3 vite	15 deri 17
Jo	I mesëm i lartë - Aftësim profesional - KKK 4	10 - 12	3 vite	15 deri 17
Jo	I mesëm i lartë - Aftësim profesional - KKK 3	10 - 11	2 vite	15 deri 16
Jo	Institucione të Arsimit dhe Aftësimi (I mesëm i lartë - Aftësim profesional) KKK 1 deri 4	1 deri < 120 ECVET	Më pak se 2 vite	15+
<b>Jo</b>	<b><i>Institucione të Arsimit dhe Aftësimi (I mesëm i lartë - Aftësim profesional) KKK 4</i></b>		<b><i>1.5 vite</i></b>	<b><i>17+</i></b>
Jo	Arsimi dhe aftësimi profesional pas-sekondar KKK5	120 ECVET	2 vite	18
Jo	Arsimi dhe aftësimi profesional pas-sekondar KKK5	1 deri <120 ECVET	më pak se 2 vite	18
Jo	Arsimi i lartë - Cikli i shkurtër akademik / KKK5	120 ECTS	2 vite (120 kredi)	18
Jo	Bachelor / KKK6	180 deri 240 ECTS	3 deri 4 vite (180 deri 240 kredi)	18
Jo	Arsimi i lartë - Cikli i shkurtër akademik / institutet në fakultete	1 deri 60 ECTS	1 vit ose më pak	21
Jo	Master / KKK 7	60 deri 120 ECTS	1 deri 2 vite (60 deri 120 kredi)	21
Jo	Studimet e doktoraturës / KKK 8		Së paku 3 vite (180 kredi)	23



Bazuar në Udhëzimin Administrativ 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore, programi për edukimin parashkollor është hartuar për fëmijët e moshës 9 muaj deri në 6 vjeç.

Gjegjësisht, edukimi parashkollor është i ndarë në dy grupe:

- Çerdhe, për fëmijë të moshës 9 muaj deri në 2 vjeç (3 vjeç në fund të programit)
- Kopsht, për fëmijët e moshës 3 deri në 5 vjeç (6 vjeç në fund të programit).

Ligji për Arsimin Parauniversitar (04/L-032) përcakton moshën për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Sipas këtij ligji, arsimi parafillor organizohet për fëmijët e moshës 5 deri 6 vjeç duke krijuar vazhdimësi me nivelet tjera dhe moshat përkatëse. Por përveç moshës, për vazhdimin e arsimit në nivelin e ardhshëm nevojitet dëshmia (certifikata) e përfundimit të nivelit përkatës, që përcaktohet në KKK.

### **b) Struktura kombëtare - kërkesat dhe kualifikimet e marra**

Siç u theksua më lartë, ndjekja e programeve në arsim përcaktohet nga mosha dhe kohëzgjatja e programit. Regjistrimi në cilindo nivel të arsimit parauniversitar është i bazuar në moshë, prandaj certifikata e lindjes dhe dëshmia e vendqëndrimit janë të domosdoshme. Por, duke filluar nga arsimi i mesëm i ulët, përveç dëshmimeve të theksuara më lartë, nevojitet edhe dëshmia për përfundimin e nivelit paraprak të arsimit. Varësisht nga niveli, kërkesat për dëshmi mund të jenë më specifike dhe plotësohen me informata shtesë mbi programin e përfunduar apo edhe përfundimin e suksesshëm të testit të Maturës. Për shembull, për të vazhduar në arsimin pas-sekondar kërkohet përfundimi i nivelit KKK 4, ndërsa certifikata e Maturës Shtetërore është e domosdoshme për të vazhduar në Arsimin e Lartë (cikël i shkurtër akademik ose Bachelor).

Për vazhdimin e studimeve në arsimin e lartë, gjegjësisht cikli i shkurtër akademik (fakultet), nevojitet diploma e nivelit 6 të KKK-së, e njëjtë me atë Bachelor. Por pasi që programet janë të dizajnuara për të qenë më të shkurtra dhe më të specializuara, por jo më komplekse në përmbajtje, edhe kualifikimet e marra janë të ndryshme (certifikatë apo diplomë).

Detajet për kushtet për pranimit apo fillim të programit dhe përfundim të tij janë paraqitur në tabelën 2.

*Tabela 2: Kushtet për të hyrë në programe dhe kualifikimet e marra në fund të programeve*

	<b>Programet</b>	<b>Kushtet për qasje/hyrje në program</b>	<b>Provimi dhe vlerësimi në fund të programit</b>
1	Parashkollor - Çerdhe		
2	Parashkollor - Kopsht		
3	Parafillor	Mosha 5 vjeç	
4	Fillor	Mosha 6 vjeç	Dëftesa/Raporti vjetor dhe certifikata për përfundimin e arsimit fillor/Provimi Shtetëror në fund të klasës 5
5	<b>Fillor - arsimit jo formal</b>	<b>Të paktën 2 vjet më shumë se mosha zyrtare e qasjes/hyrjes</b>	<b>Dëftesa e përfundimit të arsimit fillor</b>
6	I mesëm i ulët	Mosha 11 vjeç dhe dëshmia e përfundimit të arsimit fillor	Deftesa/Raporti vjetor dhe certifikata për përfundimin e arsimit të mesëm të ulët/Provimi shtetëror në fund të klasës 9
7	<b>I mesëm i ulët - Arsimit jo formal</b>	<b>Të paktën 2 vjet më shumë se mosha zyrtare e qasjes/hyrjes dhe dëshmia e përfundimit të arsimit fillor</b>	<b>Certifikatë për përfundimin e arsimit të mesëm të ulët</b>
8	I mesëm i lartë - Gjimnaz KKK 4	Mosha 15 vjeç dhe dëshmia e përfundimit të arsimit të mesëm të ulët	Përfundimi i arsimit të mesëm të lartë (diploma KKK 4) / Provimi i Maturës Shtetërore për ata që i nënshtrohen testit dhe e kalojnë
9	I mesëm i lartë - Aftësimi profesional - KKK 4	Mosha 15 vjeç dhe dëshmia e përfundimit të arsimit të mesëm të ulët	Përfundimi i arsimit të mesëm të lartë (diploma KKK 4) / Provimi i Maturës Shtetërore për ata që i nënshtrohen testit dhe e kalojnë
10	I mesëm i lartë - Aftësimi profesional - KKK 3	Mosha 15 vjeç dhe dëshmia e përfundimit të arsimit të mesëm të ulët	Certifikata e nivelit 3 të KKK-së
11	Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin (I mesëm i lartë - Aftësimi profesional) KKK 1 deri 4	Mosha 15 vjeç dhe dëshmia e përfundimit të arsimit të mesëm të ulët	Certifikata e arritjeve bazuar në nivelin e KKK, Certifikata Kombëtare Profesionale
12	<b>Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin (I mesëm i lartë - Aftësimi profesional) KKK 4</b>	<b>Të paktën 2 vjet më shumë se mosha zyrtare e regjistrimit/hyrjes dhe dëshmia e përfundimit të arsimit të mesëm të ulët</b>	<b>Përfundimi i arsimit të mesëm të lartë</b>
13	Arsimi dhe aftësimi profesional pas-sekondar KKK5	Përfundimi i arsimit të mesëm të lartë (diploma KKK 4)	Certifikatë profesionale ose diplomë
14	Arsimi dhe aftësimi profesional pas-sekondar KKK5	Përfundimi i arsimit të mesëm të lartë (diploma KKK 4)	Certifikata e arritjeve (bazuar në kredi)
15	Arsimi i lartë - Cikli i shkurtër akademik / KKK5	Certifikata e Maturës	Kualifikimi i arsimit të lartë - certifikatë ose diplomë (varësisht nga kualifikimi)
16	Bachelor / KKK6	Certifikata e Maturës	Diploma
17	Arsimi i lartë - Cikli i shkurtër akademik / fakultet	Diploma e nivelit 6 të KKK (Bachelor, të paktën 180 kredi)	Certifikata
18	Master / KKK 7	Diploma e nivelit 6 të KKK (Bachelor, të paktën 180 kredi)	Diploma
19	Studimet e doktoraturës / KKK 8	Diplomë Master (të paktën 300 kredi në Bachelor dhe e kombinuar me Master)	Diploma

### c) Struktura ISCED dhe përshtatja me arsimin kombëtar

Pas analizimit të strukturës kombëtare të arsimit dhe shqyrtimit të programeve ekzistuese, kritereve të qasjes në programe dhe kualifikimeve të arritura në fund të programit, procesi i hartëzimit me ISCED 2011 ishte në përputhshmëri me kriteret ndërkombëtare. Andaj, tabela 3 specifikon të gjitha programet e arsimit në Kosovë (gjithsej 19) të radhitura sipas ISCED 2011.

Tabela 3: Klasifikimi i strukturës së arsimit në Kosovë sipas ISCED 2011

Obligativ			NIVELI ISCED 2011	
			Klasifikimi	kodi treshifror
1	jo	Parashkollor - Çerdhe	ISCED 01	010
2	jo	Parashkollor - Kopsht	ISCED 02	020
3	jo	Parafillor	ISCED 02	020
4	po	Fillor	ISCED 1	100
5		<b>Fillor - arsimi jo formal</b>	<b>ISCED 1</b>	<b>100</b>
6	po	I mesëm i ulët	ISCED 2	244
7		<b>I mesëm i ulët - Arsimi jo formal</b>	<b>ISCED 2</b>	<b>244</b>
8	jo	I mesëm i lartë - Gjimnaz	ISCED 3	344
9	jo	I mesëm i lartë - Aftësim profesional - KKK 4	ISCED 3	354
10	jo	I mesëm i lartë - Aftësim profesional - KKK 3	ISCED 3	353
11	jo	Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin (I mesëm i lartë - Aftësim profesional) KKK 1 deri 4	ISCED 3	352
12		<b>Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin (I mesëm i lartë - Aftësimin profesional) KKK 4</b>	<b>ISCED 3</b>	<b>354</b>
13	jo	Arsimi dhe aftësimi profesional pas-sekondar KKK5	ISCED 4	454
14	jo	Arsimi dhe aftësimi profesional pas-sekondar KKK5	ISCED 4	451
15	jo	Arsimi i lartë - Cikli i shkurtër akademik / KKK5	ISCED 5	544
16	jo	Bachelor / KKK6	ISCED 6	665
17	jo	Arsimi i lartë - Cikli i shkurtër akademik / fakulteti	ISCED 6	667
18	jo	Master / KKK 7	ISCED 7	767
19	jo	Studimet e doktoraturës / KKK 8	ISCED 8	864

Procesi i hartëzimit të programeve arsimore në Kosovë ka nxjerrë disa specifika të strukturës që kanë kërkuar përshtatje me nivelet e ISCE 2011. Këto specifika janë përshkruar në vazhdim:

- Edukimi parashkollor

Fëmijët e moshës 0-2 vjeç janë përfshirë në Çerdhe dhe programi është hartëzuar me ISCED 00, gjegjësisht me nën-nivelin 02, si program parafillor.

Sipas nivelit ISCED 0, programet arsimore për zhvillim në fëmijërinë e hershme i përfshijnë fëmijët nga moshë 0 deri në 2 vjeç; kurse programet e arsimit parafillor përfshijnë fëmijët e moshës 3 vjeç deri në moshën për të filluar ISCED 1. Kufiri i sipërm i moshës për kategorinë e arsimit parafillor është i veçantë për secilin rast dhe varet nga moshë teorike e hyrjes në nivelin 1 të ISCED, d.m.th. arsimit fillor<sup>4</sup>.

Tabela 4: Hartëzimi në nivelin parashkollor dhe parafillor

	Obligativ	Programet	Kohëzgjatja	Moshë	NIVELI ISCED 2011	
					Klasifikimi	Kodi treshifror
1	jo	Parashkollor – Çerdhe	3 vite	0 - 2	ISCED 01	010
2	jo	Parashkollor – Kopsht	2 vite	3 - 4	ISCED 02	020
3	jo	Parafillor	1 vit	5	ISCED 02	020

- Arsimi i obligueshëm:

Vetëm dy programe janë të obligueshme: programi fillor dhe i mesëm i ulët, siç specifikohet në Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar: “Shkollimi i detyruar fillon në fillim të vitit shkollor pas datës kur fëmija arrin moshën gjashtë (6) vjeçare që është moshë minimale për shkollimin e detyruar dhe përfundon në fund të nivelit 2 të ISCED-së” (neni 9).

- Programet joformale:

Nxënësit në programe joformale, pas përfundimit certifikohen sipas ligjeve në fuqi, ngjashëm me nxënësit në programet formale. Moshat e nxënësve ndryshojnë.

- Arsimi i mesëm i lartë - kodi tre-shifror për KKK 3 dhe KKK 4:

Për kategorizimin e disa programeve arsimore për të gjitha nivelet, KKK ishte e dobishme e posaqërisht për t'i sqaruar kualifikimet e marra për programet arsimore

Kodi tre-shifror për KKK 3 është **353**:

Programi është i mesëm i lartë (ISCED) **3**

Programi është profesional **(5)**

Programi është i dizajnuar për të përfunduar pas 2 vitesh, pa mundësi të qasjes në nivelin e ardhshëm të arsimit **(3)**

4 Burimi: UIS, 2012, faqe 27

të nivelit 3 dhe 4 të KKK-së. Sipas këtij dokumenti, kualifikimet e marra me përfundimin e nivelit 3 të KKK-së nuk çojnë në nivel më të lartë të arsimit, por i përgatisin të rinjtë për tregun e punës. Niveli 3 përfshin kualifikimet e marra pas përfundimit të dy viteve të nivelit të lartë të arsimit profesional dhe certifikatat e marra pas përfundimit të kurseve të shkurtra të trajnimeve të ofruara nga AAP.

Tabela 5: Kodet e ndryshme të ISCED për NQF 3 dhe NQF 4

	Programet kombëtare	Klasa	Kohëzgjatja	Mosha	Provimi dhe vlerësimi në fund të programit	ISCED 2011 NIVELI	
8	I mesëm i lartë - Gjimnaz KKK 4	10 - 12	3 vite	15 - 17	Përfundimi i arsimit të mesëm të lartë (diploma KKK 4) / Provimi i Maturës Shtetërore për ata që i nënshtrohen testit dhe e kalojnë atë	ISCED 3	344
9	I mesëm i lartë - Arsim dhe Aftësim profesional - KKK 4	10 - 12	3 vite	15 - 17	Përfundimi i arsimit të mesëm të lartë (diploma KKK 4) / Provimi i Maturës Shtetërore për ata që i nënshtrohen testit dhe e kalojnë atë	ISCED 3	354
10	I mesëm i lartë - Arsim dhe Aftësim profesional - KKK 3	10 - 11	2 vite	15 - 16	Certifikata e nivelit 3 të KKK-së	ISCED 3	353
11	Institucione të Arsimit dhe Aftësimi Profesional (I mesëm i lartë - Arsimi dhe Aftësimi profesional) KKK 1 deri 4	1 < 120 ECVET	Më pak se 2 vite	15+	Certifikata e arritjeve bazuar në nivelin e KKK-së, Certifikata Kombëtare Profesionale	ISCED 3	352

- Programet pas-sekondare KKK 5 - klasifikuar si në ISCED 4 ashtu edhe në ISCED 5:

Bazuar në Kornizën Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, programet pas-sekondare janë klasifikuar në ISCED 4. Andaj, arsimi pas-sekondar jouniversitar ndjek (është vazhdimësi) arsimin e mesëm të lartë dhe kandidatët e kualifikuar duhet të jenë mbi moshën 18 vjeçare. Bazuar në KKK, diploma e marrë në këtë nivel arsimi do të korrespondojë me nivelin e kualifikimit 5, i cili do të shërbejë për hyrje në tregun e punës ose rikualifikim për punë të caktuara.

Cikli i Shkurtër Akademik në Arsimin e lartë që gjithashtu është KKK 5 në strukturën kombëtare, klasifikohet si program i shkurtër në ISCED 5, pasi që për të hyrë në program kërkohet provimi i Maturës Shtetërore dhe kreditë e përdorura në program janë të ndryshme (ECTS - Sistemi Evropian i Transferimit të Kredive) për ciklin e shkurtër dhe ECVET për arsimin pas-sekondar)

Tabela 6: Klasifikimi i programeve të KKK 5

	Programet	Kreditë	Kohëzgjatja	Provimi dhe vlerësimi në fund të programit	NIVELI ISCED 2011	
					Klasifikimi	Kodi treshifror
13	Arsimi dhe aftësimi profesional pas-sekondar KKK5	120 ECVET	2 vite	Përfundimi i arsimit të mesëm të lartë (diploma KKK 4)	ISCED 4	454
14	Arsimi dhe aftësimi profesional pas-sekondar KKK5	1 <120 ECVET	më pak se 2 vite	Përfundimi i arsimit të mesëm të lartë (diploma KKK 4)	ISCED 4	451
15	Arsimi i lartë - Cikli i shkurtër akademik / KKK5	120 ECTS	2 vite (120 kredi)	Certifikata e Maturës Shtetërore	ISCED 5	544

### 3. Profilet e programeve të arsimit të mesëm të lartë

Siç u përmend më herët, Korniza Kombëtare e Kualifikimeve dhe Raporti i Referencimit me Kornizën Europiane të Kualifikimeve (2016) thekson se në arsimin e mesëm të lartë janë 140 profile për programet e arsimit dhe aftësimit profesional që mund të kategorizohen në 17 fusha profesionale.

Për këtë ushtrim, grupi punues i identifikoi 171 profile të programeve të arsimit të mesëm të lartë për t'u kodifikuar në ISCED-F 2013 (166 nga profilet janë programe profesionale, ndërsa 5 janë programe të Gjimnazit).

### 4. Kodifikimi ISCED F 2013

Fushat e Arsimit dhe Aftësimit ISCED-F 2013 i klasifikojnë programet arsimore sipas fushave të studimit të përcaktuara si "fusha, dega ose zona e gjerë e përmbajtjes e mbuluar nga një program arsimor" (UIS, 2014, f.5). Ekzistojnë 11 fusha të gjera të arsimit (00 deri në 10), 29 fusha të ngushta dhe rreth 80 fusha të detajuara (Tabela 7 dhe 8).

Tabela 7: Fushat e gjera dhe të ngushta të arsimit (ISCED F - 2013)

ISCED – Fushat e Arsimit dhe Aftësimit 2013	
00 Programet dhe kualifikimet e përgjithshme	06 Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
001 Programet dhe kualifikimet themelore	061 Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
002 Shkrim-leximi dhe numërimi	07 Inxhinieria, prodhimi dhe ndërtimtaria
003 Aftësitë dhe zhvillimi personal	071 Inxhinieria dhe profesionet e inxhinierisë
01 Arsimi	072 Prodhimi dhe përpunimi
011 Arsimi	073 Arkitektura dhe ndërtimtaria
02 Artet dhe shkencat humane	08 Bujqësia, pylltaria, peshkataria dhe veterinaria
021 Artet	081 Bujqësia

022 Shkencat humane	082 Pylltaria
023 Gjuhët	083 Peshkataria
03 Shkencat sociale, gazetaria dhe informimi	084 Veterinaria
031 Shkencat sociale dhe biheviore	09 Shëndeti dhe mirëqenia
032 Gazetaria dhe informimi	091 Shëndeti
04 Biznesi, administrata dhe ligji	092 Mirëqenia
041 Biznesi dhe administrata	10 Shërbimet
042 Drejtësia	101 Shërbimet personale
05 Shkencat natyrore, matematika dhe statistika	102 Shërbimet e higjienës dhe shëndetit në punë
051 Shkencat biologjike dhe të ndërlidhura	103 Shërbimet e sigurisë
052 Mjedisi	104 Shërbimet e transportit
053 Shkencat fizike	
054 Matematika dhe statistika	

Burimi: UIS, 2014, faqe 15.

KKK është një nga mjetet kryesore reformuese në sistemin e arsimit që synon ta përmirësojë qasjen në punë dhe të mësuarit e mëtejshëm duke i bërë kualifikimet të rëndësishme për punësim dhe mësim dhe për plotësimin e nevojave të nxënësve, ekonomisë dhe institucioneve arsimore dhe aftësuese. KKK gjithashtu synon të krijojë një bazë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellë duke u lidhur me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për Mësimin Gjatë Gjithë Jetës (EQF). Këto dokumente kanë qenë bazike për klasifikimin e 171 profileve ekzistuese në nivelet e ISCED F 2013. Profilet e klasifikuara hollësisht janë përshkruar në Shtojcën 2 të këtij dokumenti.

Tabela 8: Struktura e bazës së të dhënave që klasifikon fushën e studimit të programeve të arsimit të mesëm të lartë për fushën e Biznesit, administratës dhe ligjit

Profili	Struktura kombëtare	KKK	Niveli ISCED	FoE_Kodi	FoE_Fusha e detajuar	FoE_Fusha e ngushtë	FoE_Fusha e gjerë
Administrim biznesi	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0413	0413 Mënxhim dhe administrim	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Administrim zyreje	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0413	0413 Mënxhim dhe administrim	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Asistent financiar	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0412	0412 Banka, financa dhe sigurime	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Asistent i administratës	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0415	0415 Punë sekretarie dhe zyreje	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Asistent i sigurimeve	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0412	0412 Banka, financa dhe sigurime	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Asistent juridik	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0415	0415 Punë sekretarie dhe zyreje	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Asistent marketingu	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0414	0414 Marketing dhe reklamim	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji


Banka dhe shërbimet e sigurimeve	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0412	0412 Banka, financa dhe sigurime	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Banka dhe sigurime	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0412	0412 Banka, financa dhe sigurime	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Bankier	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0412	0412 Banka, financa dhe sigurime	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Financa	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0412	0412 Banka, financa dhe sigurime	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Kontabilist	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0411	0411 Kontabilitet dhe tatimet	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Logjistika dhe operimi në magazinë	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0416	0416 Shitje me shumicë dhe pakicë	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Marketing	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0414	0414 Marketing dhe reklamim	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Menaxhim biznesi	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0413	0413 Menaxhim dhe administrim	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Nëpunës banke	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0412	0412 Banka, financa dhe sigurime	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Nëpunës export-importi	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0416	0416 Shitje me shumicë dhe pakicë	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Nëpunës i financave	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0412	0412 Banka, financa dhe sigurime	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Nëpunës industrie	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0413	0413 Menaxhim dhe administrim	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Nëpunës marketingu	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0414	0414 Marketing dhe reklamim	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Nëpunës për zhvillimin e burimeve njerëzore	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0413	0413 Menaxhim dhe administrim	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Operator i prodhimit	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0417	0417 Aftësi pune	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Shërbime ndaj konsumatorit dhe shitjes	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0416	0416 Shitje me shumicë dhe pakicë	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Shërbimet e zyrës dhe administratës publike	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0415	0415 Punë sekretarie dhe zyreje	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji



Shitja dhe marketingu	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0414	0414 Marketing dhe reklamim	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Teknik i informatikës së biznesit	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0415	0415 Punë sekretarie dhe zyreje	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Tregtar me pakicë dhe shumicë	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0416	0416 Shitje me shumicë dhe pakicë	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Tregti me pakicë	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0416	0416 Shitje me shumicë dhe pakicë	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji
Tregti me shumicë	Arsimi i mesëm i lartë - Profesional	KKK-4	354	0416	0416 Shitje me shumicë dhe pakicë	041 Biznesi dhe administrata	04 Biznesi, administrata dhe ligji

Në Kosovë, nga 80 fusha të mundshme të detajuara, vetëm 49 janë përdorur në klasifikimin e programeve të arsimit të mesëm të lartë. Figura 4 paraqet shpërndarjen e programeve sipas fushave të gjera të studimit. Fusha e gjerë 07 për Inxhinieri, Prodhim dhe Ndërtim ka më së shumti programe të klasifikuara në këtë fushë, gjithsej 57 apo 33% prej të gjitha programeve të arsimit të mesëm të lartë. Programet në Biznes, Administrim dhe Drejtësi (Fusha 04) dhe Arte dhe Shkenca Humane (Fusha 02) janë fushat e dyta dhe të treta me 30, respektivisht, 22 programe të klasifikuara.

Figura 6: Shpërndarja e programeve në arsimin e mesëm të lartë sipas fushave të gjera të arsimit (ISCED-F 2013)



## IV. Përfundim dhe rekomandime

Korniza e ISCED-it shërben për mbledhjen, përpilimin dhe analizimin e statistikave ndërkombëtarisht të krahasueshme për arsim dhe për këtë arsye, vendet kanë nevojë për hartëzimin e statistikave kombëtare të arsimit sipas ISCED-it për të qenë në gjendje të raportojnë të dhënat e tyre kombëtare të arsimit, pa pasur nevojë të ndryshohet struktura kombëtare e arsimit. Hartëzimi u mundëson vendeve t'i raportojnë të dhënat e tyre kombëtare tek organizatat ndërkombëtare që mbledhin statistika të krahasueshme të arsimit si UIS, Eurostat dhe OECD pa e ndryshuar klasifikimin e arsimit në nivelin kombëtar.

